



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 3997 / Prot. 6

Divjakë, më 13.05. 2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. 44, datë 13.05. 2026

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 89, DATË 29.12.2025, “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE NË VARËSI, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE TË FUNKSIONEVE TË DELEGUARA PËR VITIN 2026”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 54, gërma “dh”, të VKB-së nr. 89, datë 29.12.2025, “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi, njësive administrative dhe funksioneve të deleguara për vitin 2026”, i ndryshuar, i propozohet Këshillit të Bashkisë Divjakë që, në mbledhjen e datës 25.05.2026,

Të miratojë:

1. Shkurtimin e “**Sektorit të Shërbimeve Turistike**”, në varësi të Drejtorisë së Kulturës, Sportit dhe Turizmit, me përbërje prej 9 (nëntë) punonjësish, si vijon:
 - 2 (dy) punonjës të shërbimeve turistike;
 - 2 (dy) sportelistë (kulla dhe varkat);
 - 4 (katër) varkëtarë;
 - 1 (një) roje nate.



2. Shkurtimin e pozicionit **“1 Punonjës tregu”**, pjesë e Sektorit të Vlerësimit dhe Kontrollit, në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore.
3. Shkurtimin e 13 pozicioneve në Agjencinë e Shërbimeve Komunale, si vijon:
 - 1 (një) përgjegjës i menaxhimit të mbetjeve;
 - 3 (tre) shoferë të makinave teknologjike;
 - 9 (nëntë) punëtorë të makinave teknologjike.
4. Si rrjedhojë e shkurtimeve të pozicioneve të mësipërme, numri i punonjësve të administratës qendër të Bashkisë ndryshon nga **141** (njëqind e dyzet e një) punonjës në **131** (njëqind e tridhjetë e një) punonjës, duke u shkurtuar **10** (dhjetë) pozicione.
5. Numri i punonjësve të Agjencisë së Shërbimeve Komunale ndryshon nga **115** (njëqind e pesëmbëdhjetë) punonjës në **102** (njëqind e dy) punonjës, duke u shkurtuar **13** (trembëdhjetë) pozicione.
6. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Divjake, institucioneve në varësi, njësive administrative dhe funksioneve të deleguara ndryshon nga **486** (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) punonjës në **463** (katërqind e gjashtëdhjetë e tre) punonjës, duke u shkurtuar gjithsej **23** (njëzet e tre) pozicione pune.

**Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore
dhe Shërbimeve të Brendshme**

Atalanta Simaku

Për Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit

Xheladin Brahkola

**Për Drejtorinë Juridike, Prokurimeve Publike
dhe Menaxhimit Aseteve**

Andi Bullari

Për Agjencinë e Shërbimeve Komunale

Eridian Hoxha

**KRYETARI
JOSIF GORREA**

